

# horizonte

**Demokraci,  
participim dhe  
të drejta të  
njëta për të  
gjithë në Zvicër!**

**Politika sindikaliste  
ndërkombëtare**

**S'ka botëror futbollit pa  
të drejta të punëmarrësve** **2**

**Fuqizimi i frangur  
dhe industria e orëve**

**Të vihet kufiri  
për këmbimin e Euros** **3**

**Sindikalistët  
shqiptar në Zvicër**

**Seminar me debat  
të gjallë dhe të thellë** **4**



Nr. 4 | korrik 2015 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**Politika e migracionit, Iniciativa për migrim masiv**

## Thjeshtë: JO



**Në fund të majit ka përfunduar afati i konsultimit mbi ndryshimin e ligjit për të huajt. Ky ndryshim është pjesë e zbatimit të iniciativë mbi migrimin masiv. Unia dhe Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës refuzojnë propozimin e qeverisë federale qartë dhe në mënyrë kategorike. Për shkak se ky propozim do të përkeqëson kushtet e punës dhe do të ushqen ksenofobinë.**

Propozimi i qeverisë federale pos tjerash parasheh që të ketë numra maksimal, të cilët kanë të bëjnë me të gjitha kategoritë: Azilkerkuesit, leje-qëndrimet dhe kalimtarët e kufirit. Nga kontingjentet do të përjashtoheshin të gjitha leje-qëndrimet nën katër muaj. Pos tjerash qeveria federale propozon ndryshime në pjesën e integritimit në ligjin për të huajt, shtrëngime përkeqësimi me rastin e dhënies së lejeve C si dhe me rastin e bashkimit familjar.

### Thjeshtë gabim

Propozimi në fjalë i cilëson migrantët si fajtorë, gjoja për problemet ekzistuese në tregun e punës. Më shumë qëndron e kundërta, pasi migrantët kanë ardhur në Zvicër për të plotësuar boshllëkun e krijuar në mungesë të fuqisë punëtore vendëse për vendet e krijuara të punës. Për këtë gjendje fajtorë është edhe poli-

tika e arsimimit të Zvicrës, e cila në disa sektorë kualifikon shumë pak fuqi profesionale, ndërsa përfiton nga angazhimet arsimore të vendeve tjera. Shumë vende pune janë fizikisht të rënda dhe me pak prestigj. Edhe këto punë kryhen kryesisht nga migrantët, pasi askush tjetër nuk është i gatshëm ti kryej ato.

### Përkeqësimi

Posaçërisht Unia në qëndrimet e saja kritikon heqjen nga kontingjentet lejet e shkurtra të qëndrimit deri në katër muaj. Ky është përkeqësim i statutit të qëndrimit dhe është e qartë se shumë punëdhënës e keqpërdorin këtë mundësi. Do të jenë migrantet e migrantët ta që do të bartin pasojat e këtij përkeqësimi. Kjo jo vetëm që do të përkeqëson së tepërmi kushtet e punës për të gjithë punëmarrësit, por edhe kushtet e jetesës të këtyre njerëzve.

### Përhëndetja nga bilateralet

Pos tjerash Unia në qëndrimin e saj e qartëson: me kontingjente nuk ka lëvizje të lirë personash, pa qarkullim të lirë të njerëzve s'ka bilaterale. Pasi Unia është e bindur, se BE-ja nuk do të lëshojë dhe do të kërkojë bisedime pasuese. Andaj edhe nuk ka alternativa: Zvicra ka nevojë për të definuar qartë marrëdhënie me BE-në, të cilat janë të qëndrueshme. Natyrisht vetëm nëse vlejné pagat dhe kushtet e punës zvicerane.

### Integrimi?

Edhe dy dokumentet tjera të propozuara, të cilat janë dërguar për këshillim, janë vlerësuar negativisht nga Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS). Si pozitive SGB/USS nënvizon risinë se refugjatët e pranuar për kohësisht do të guxojnë të punojnë. Mirëpo SGB/USS paralajmëron që mos të detyrojë ata të punojnë me paga të ulëta dhe kushte përkeqësimi pune e që nuk u përgjigjen kualifikimeve dhe aftësive të tyre. Të pesë iniciativat parlamentare, të cilat rishitas duhet integruar në ligjin për të huajt, SGB/USS i refuzon kategorikisht. Iniciativat parashohin në parim një shtrëngim të përkeqësuar për mbajtjen e lejes C të qëndrimit dhe të bashkimit familjar. Kështu shembulli bie «deficitet integruese» do të mundësojnë heqjen e lejes së qëndrimit të përhershëm C.

### Promovim pa mbështetje

Si duket, Qeveria federale dhe Parlamenti duan më shumë promovim kërkesash se sa mbështetje. Në vend të sigurisë së qëndrimit kemi më shumë pasiguri, në vend të barazisë së shanseve kemi edhe më pak dhe familjet nuk guxojnë të jetojnë bashkërisht. Ashtu si theksojnë edhe organizatat joqeveritare që angazhohen për shtresat e pambrojtura si «Solidarité Sans Frontières» dhe «grundrechte.ch» në qëndrimet e tyre: Të drejtat hiqen, dhe si zëvendësim obligimet për migrantët shumohen. Në qëndrimet e tyre shihet qartas se ata që jetojnë në kushte të këqija do ta kenë edhe më të vështirë. Refugjatët, statusi i të cilëve do të përkeqësohet edhe më tej, nëse për ta nuk do të ketë kontingjente edhe më tej, dhe pjesëtarët e shteteve të treta, të cilët do t kenë edhe më të vështirë për të prurë familjet e tyre në Zvicër.

✉ Aurora García



Pamje nga një aksion për të drejta të njëjta për të gjithë

## Editorial



### Të dashur/a lexues/e

Një Zvicër e hapur dhe solidare, momentalisht jemi shumë larg nga kjo. Më shumë jemi duke shkuar në drejtim të mbylljes dhe mundësisht sa më pak ndihmese – pasi kështu ndoshta nuk vjen askush, ngase Zvicra bëhet jo atraktive. Shumëkush nuk qan kokën që deti Mesdhe është shndërruar në një varrezë, apo shumë njerëz në Zvicër jetojnë me dekada me frikë të dëbohen në një vend, i cili në ndërkohë është bërë i huaj për ta, ose që është bërë i rrezikshëm për jetën e tyre, apo edhe të tillë që bëjnë gjumin në automjetet e tyre.

Jo, shumicës i duket logjike që njerëzit të cilët jetojnë këtu trajtojnë si të huaj, si problematik. Në mendim të kundërt, kush jeton këtu atëherë edhe është pjesë e Zvicrës. Zvicra e sotme, si e tillë edhe është formësuar nga ne migrantët. Andaj ne duhet të pranojmë këtë diversitet tonë, pasi përndryshe e mohojmë një pjesë të saj. Ne nuk duhet ti shohim migrantet/ët si problem. Kjo në të vërtetë është shmagje nga problemet që ne i kemi: Të pasurit pasurohen edhe më shumë, mirëpo për shembull njerëzit e moshuar nuk mund të jetojnë me dinjitet. Nëse ne do të ishim solidar, do të kishim më mjaftueshëm për të gjithë. Dhe kur paraprkishtë dikush shihet si i padëshiruar, për ta është e vështirë të ndërtojnë një atdhe në Zvicër.

Solidariteti dhe çiltërsia i kishte për zemër «qytetarit botëror» (kozmpolitit) dhe aktivisti i vjetër i Unia-s. Ai vdiq më 16 maj. Ai na mungon së tepërmi, ngase ishte për ne një shembull dhe forcë lëvizëse në luftën për të drejtat e migrantëve. Këtë numër ia kushtojmë atij, andaj edhe është vënë fotoja e tij tek Editoriali dhe unë kësaj radhe dua ta përfundojë me një fjalë të tij të dashur «La lotta continua» (Lufta vijon më tej!) Ne do të luftojmë më tej Govanni!

Aurora García

Sekretare nacionale për migracion



News

**14 qershor: dy JO dhe dy PO**

Në votimet federale të datës 14 qershor 2015 u aprovua me pak diferencë ligji për taksat e Radiotelevizionit Zvicëran (RTVG). Gjithashtu njëjtë kaloi edhe iniciativa për diagnostikën e implantimit. Por në të kundërtën u refuzuan iniciativa mbi bursat dhe ajo mbi tatamin për trashigimën.

**Gjyqi i qarkut vërteton të drejtën e qasjes**

Gjyqi i qarkut të Bülach-ut më 15.6.2015 ka liruar nga akuzat një punonjës të sindikatës Unia. Lirimi e vërteton edhe njëherë që sindikatave duhet lejuar e drejta e qasjes në vendet e punës, për të kryer punën e tyre.

**Pagat minimale në Tiçino**

Votuesit e Kantonit Tiçino (të Zvicrës italiane) në fundjavën e 14 qershorit ka aprovuar një iniciativë mbi pagat minimale. Politikisht, ky është një sinjal i rëndësishëm kundër dumpigut në paga. Se a do të luftohet kjo me iniciativën e aprovuar, kjo është ende një pikëpyetje dhe mbetet të shihet.

**Rishikimi i evidentimit të orarit të punës**

Të gjitha ndërmarrjet janë të obliguara, të evidentojnë orarin e punës të punonjësve të tyre, për ti mbrojtur ata nga puna falas dhe ngarkesat e tepërta. Mirëpo kjo nga shumica nuk bëhet mjaftueshëm. Andaj sindikatat dhe shoqatat e punëmarrësve janë pajtuar për revidim. Unia e mbështet këtë kompromis me shtërgim dhëmbësh dhe si kundërshtim kërkon kontrolle më të mira. Nëse relaksohet evidentimi i orarit të punës, atëherë si kundërshtim duhet të përmirësohen ndieshëm kontrollet nëpër ndërmarrje. Për këtë arsye Unia kërkon që inspektoriatet kantonale të kenë më shumë resurse të personelit si dhe financiare, për të zbatuar këto kontrolle. Ndryshimet e planifikuara të evidentimit të orarit të punës parashihen të hyjnë në fuqi në vjeshtë të këtij viti.

**Përfundoi konflikti në Mecalp**



Pas dy ditësh grevë dhe bisedimeve të gjata në fillim të qershorit firma prodhuese e pjesëve të automjeteve Mecals dhe punonjësit e pëfaqësuar nga Unia arritën të pajtohen. Ndërmarrja do të heq dorë nga shlyerja e paralajmëruar e vendeve të punës dhe nga shkurtimet në paga.

**Politika sindikaliste ndërkombëtare**

**Stop skllavërimin në kantieret e FIFA-s**

**Në kantieret e stadioneve të botërorit në futboll për vitin 2022 në Katar mbretëron gjendje katastrofale. 200 aktiviste e aktivistë, ndër ta edhe nga Unia, më 29 maj para stadionit „Hallenstadion“ të Cyrihut përmes 100 varreve simbolike kërkuar që komiteti ekzekutiv i FIFA-s më në fuqi të marrë përsipër përgjegjësinë sociale.**

Në kantieret e Katarit mbretërojnë kushte jonjerëzore. Punëtorët e ndërtimtarisë, parasëgjithash migrantët nga Azia jugore trajtohen si skllavër. Nuk respektohen të drejtat elementare në punë. Për shkak të kushteve të këqija të punës dhe të jetesës deri më tani kanë vdekur me qindëra punëtorë ndërtimtarie. Për të përkujtuar punëtorët e vdekur të ndërtimtarisë, sindikata Unia, Solidar Suisse dhe Shoqata ndërkombëtare e ndërtimtarisë dhe përpunimit të drurit (BHI/IBB).

**S'ka botëror futbollit pa të drejta të punëmarrësve**

Ka një kohë të gjatë që BHI/IBB ka startuar me fushatën «Karton të kuq për FIFA – S'ka Pokal botëror pa të drejta të punëmarrësve». Është jo vetëm përmirësimi i kushteve të punës së punëtorëve të ndërtimtarisë, të cilët ndërtojnë stadiumet, porse edhe të përmirësojnë të drejtat e punëmarrësve. Pikërisht në Katar punëtorët e ndërtimtarisë për shkak të sistemit Kafala (secilit punëtor i nevojitet një padron, i cili mundëson një leje



Pamje nga aksioni simbolik me 100 kryqe e varre

pune dhe tek i cili dorëzohet pasaporta) nuk guxojnë të anëtarësohen në sindikatë dhe kështu mbesin në (pa)mëshirën e padronit.

**S'ka botëror futbollit në varrezat e punëtorëve të ndërtimit**

Nuk është e përnueshme dhe në rregull, që një manifestim kaq madhështor si kupa e futbollit botëror të zhvillohet në varret e punëtorëve të ndërtimit. FIFA duhet të marrë përsipër përgjegjësinë për kushtet jodinjtoze njerëzore në kantieret

e stadioneve të kupës së botërorit në Katar. FIFA duhet të kujdeset që ndërmarrjet e ndërtimtarisë dhe qeveritë e shteteve nikoqire tu përmbahen rregullave të qarta. Të drejtat e njeriut dhe ato të punës duhet të respektohen bazuar në normat themelore të Orgnaizatës Ndërkombëtare të Punës (IAO-OIT-OIL). Punëtorët e ndërtimit, që cilët ndërtojnë stadiumet e kupës së botërorit, i takojnë ekipit. Ata meritojnë respekt dhe jeta e tyre duhet të mbrohet.

Aurora García



Aksion i shoqëruar me fjalime



Fajtoje për punëtorët e vdekur FIFA

**Përkujdesa e pleqërisë, Iniciativa popullore AHV/AVSplus**

**Për një pensionim të mirë pleqëria!**



Pamje nga aksioni për fuqizimin e pensioneve të pleqërisë

**Këshilli federal i kantoneve më 9 qershor ka trajtuar iniciativën popullore AHV/AVSplus: «Për shtyllën e fuqishme të pensionit bazik shoqëror AHV/AVS» dhe ashtu si është pritur, ngadhënjeu shumica borgjeze. «Kjo nuk mund të financohet» ishte arsyeja më e shpeshtë e përmendur, edhe pse në fakt Zvicra posedon mjaft para! Iniciativa do të hidhet në votim sipas të gjitha gjasave vitin e ardhshëm. Andaj qysh tani vlen: të angazhohemi fuqishëm për një AHV/AVSplus, pasi fuqizimi i pensionit të pleqërisë është më se i nevojshëm!**

Të fillojmë me përmbajtjen e iniciativës: AHV/AVSplus kërkon rritjen e të gjitha pensioneve të pleqërisë për 10%. Rritja do të paguhet si shtesë për pensionet aktuale dhe ato të ardhshme. As përlloraritjet aktuale dhe as sistematika e kontributeve të pensionit nuk do të ndryshojnë. Kontributet tjera të pensionit të pleqërisë (AHV/AVS) dhe të invaliditetit (IV/Al) edhe më tej do të mbështeten në pensionin e «rregullt» të pleqërisë pa shtesën. Shtesa AHV/AVSplus nuk

qon në ndryshime tek pensioni i përkujdesjes profesionale. Shtesa duhet të paguhet më së voni dy vite pas aprovimit të iniciativës. Pjesa më madhe e pensioneve të pleqërisë do të merr një shtesë prej 200 frangave në muaj, ndërsa qiftet një rritje prej 350 frangave. Pensioni minimal i pleqërisë AHV/AVS do të rritej për 118 franga, ndërsa ai maksimal për 235 franga. Plafoni maksimal i pensionit të qifteve me 353 franga do të rritej në 3878.– franga.

**Pensionet aktuale AHV/AVS tejet të ulëta**

Përse është e nevojshme iniciativa AHV/AVSplus? Kush pensionohet, duhet që me pensionin e vet të AHV/AVS të ketë mundësinë «të vijoj jetën e zakonshme në mënyrën e përshatshme». Kështu qëndron në kushtetutën federale. Pensionistët që kanë pasur të ardhura paraprake të ulëta apo të mesme nuk kanë mundësi të jetojnë vetëm nga pensioni i tyre i AHV/AVS. Shumë nga ta janë të detyruar të marrin edhe kontribute shtesë. Kjo duhet të marrë fund, pensionet duhet të rriten.

**Pensione solide të AHV/AVS**

Edhe përkundër skenarëve që predikojnë fundin e botës, AHV/AVS megjithatë qëndron mirë. Ajo shkruan numra të zinj edhe pse numri i pensionistëve qysh nga futja e AHV/AVS është gjashtëfishuar dhe aktualisht numri i tyre është 2 milionë. Edhe përkundër jetëgjatësisë dhe zvogëlimi i numrit të lindjeve (demografia) – sot paguajnë 2,5 të punësuar me orar të plotë për një pensionist të AHV/AVS, ndërsa në fillim ishin 4,5 të punësuar – megjithatë AHV/AVS ka mbijetuar. Shtimi i mundshëm i pensionistëve të rinj mund të jetë një fenomen i përkohshëm, pasi që të ardhurat shtesë mund të amortizohen përmes rritjes së tatimit në vlerë, deri në kohën kur gjenerata e dobësuar nga lindjet e pakta të shkojnë në pension.

**Kostoja: modeste dhe e arsyeshme**

Por a është AHV/AVSplus e mundshme? Po! Rritja e pensionit për 10% kushton rreth 4.1 miliarda franga, gjegjësisht 3.7 miliarda franga nëse marrim parasysh kursimet nga të ardhurat shtesë suplementare. AHV/AVS është një sigurim, i cili në pjesën më të madhe financohet nga kontributet e pagave. Për përfitime më të mira nga ky sigurim, janë të justifikuar kontributet më të larta të pagave. Përdërisa për sigurimet tjera shoqërore janë rritur kontributet financuese – fjala bie arkat e pensionit – kontributet për AHV/AVS ka 40 vite që nuk janë përshtatur. Nevojat financuese për të rritur pensionet në shumën prej 200 frangave në muaj për shumicën e pensioneve të pleqërisë dhe 350 franga për çifte është barazi me 0,5% për punëdhënësin dhe punëmarrësin. Tek një pagë vjetore bruto prej 54000 frangave pagesa shtesë e kontributeve për një vit do të ishte vetëm 270 franga. Kështu mundësohet një rritje pensionesh prej 2000 frangave. Financimi përmes përqindjeve të pagave është pra e arsyeshme dhe e mbështetshme. Kostoja anësore e pagave për AHV/AVS me 4,7% mbetet edhe më tej e ultë.

AHV/AVSplus pra është e mundshme të financohet dhe është një hap i mirë drejt rritjes së pensioneve. Dhe kjo tani është më se e nevojshme!

Aurora García



Frangu i fuqizuar, Industria e orëve

# Kurs këmbyes minimal të Euro-s tani!



Pamje nga aksioni i protestës të delegatëve të industrisë në kuadër të sindikatës Unia

**Rreth 60 delegat të ndërmarrjeve të ndryshme të Industrisë të sindikatës Unia kanë organizuar një aksion proteste në sheshin federal të Bernës. Ata kanë kërkuar posaçërisht rifutjen e kursit të këmbimit për Euro-n, i cili do të garantojë ekzistencën e mëtejme të Zvicrës si vendndodhje e Insudtrisë. Nëse nuk vepron, Banka Kombëtare e Zvicrës rrezikon të shkatërroi mijëra vende pune.**

Shifrat më të reja të eksportit vërtetojnë: me vendimin e saj për të hequr kufizimin e kursit këmbyes për Euro-n, Banka Kombëtare Zvicrës shtynë ekonominë në krizë. Frangu i tejshtrënjëtuar kërcënon të shkatërojë vendndodhjen industriale të Zvicrës – me mijëra vende pune vehen në rrezik. Me kërcënimet reduktuese humbet edhe përvoja e shumë punëmarrësve, njëri ndër faktorët qëndror të suksesit të industrisë zvicëranë.

## Të veprohet tani!

Delegatët e konferencës industriale të Unia-s kundërshtojnë fuqishëm rrizikun e desindustrializimit. Më 5 qershor ata zhvilluan një aksion protestues dhe i dorëzuan nënkryetarit të Bankës Kombëtare të Zvicrës. Jean-Pierre Danthine një rezolutë dhe një orë të madhe me zile. Kjo orë tregon kohën 5 minuta para orës 12, pasi është koha e fundit që Banka Kombëtare e Zvicrës të

veprojë. Punëtorët/ët kërkojnë pavyonesë një mori masash, të cilat mbrrojnë vendprodhimin. Si masë të rëndësishme që duhet ndërmarrë, ata kërkojnë përcaktimin e kursit këmbyes korrekt dhe fuqizimin e politikës së kamatës negative, për ndalimin e tejvlerësimit të frangut. Në të njëjtën kohë, ata kërkojnë të hiqen sigurimet shoqërore nga kamatat negative, për të siguruar kursimet e popullatës.

Vetëm përmes politikës së vendosur për ruajtjen e Zvicrës si vendprodhimi mund të ruhet prodhimi ynë i kualitetit të lartë – dhe kështu të ruhen edhe mijëra vende pune.

➤ Aurora Garcia

## Kuvendi i Forumit për integrim të migranteve/eve

# Kuvendi i FIMM planifikon aktivitete të mëtejme

**Më 12.05.2015 në Bernë, rreth 30 delegatë dhe mysafirë të Forumit për integrim të migranteve/eve (FIMM) të Zvicrës u takuan për herë të nëntë në kuvendin e tyre vjetor. Në fjalën e saj të hapjes kryetarja e FIMM, Emine Sariaslan ishte vetëkritike dhe theksoi se FIMM nuk guxon të shndërrohet thjeshtë në organizatë projektsh, porse të fuqizojë aktivitetet e saja politike. Ajo u falënderua edhe tek financuesit privat dhe publik, të cilët kanë mbështetur punën e deritashme projektuese dhe që kanë mundësuar vijimi e projekteve.**

Më 12.5.2015 në Bernë, rreth 30 delegatë dhe mysafirë të Forumit për integrim të migranteve/eve (FIMM) të Zvicrës u takuan për herë të nëntë në kuvendin e tyre vjetor. Në fjalën e saj të hapjes kryetarja e FIMM, Emine Sariaslan ishte vetëkritike dhe theksoi se FIMM nuk guxon të shndërrohet thjeshtë në organizatë projektsh, porse të fuqizojë aktivitetet e saja politike. Ajo u falënderua edhe tek financuesit privat dhe publik, të cilët kanë mbështetur punën e deritashme projektuese dhe që kanë mundësuar vijimi e projekteve.

Për vitin që jemi sipas deklaratës së presidentes të FIMM-it duhet të fuqizohet bashkëpunimi me organizatat tjera, partitë, sindikatat si dhe institucioneve që veprojnë në fushën e integritimit. Temat e ngutshme kanë të bëjnë me sulmet e SVP-së në të drejtën e popujve, iniciativa mbi

mbulesën, si dhe zbatimin e iniciativës mbi migrimin masiv. Në kantonin e Bernës kryetarja ka zhvilluar bisedime të ndryshe për të gjetur mbështetje dhe bashkëpunëtor në luftën kundër shtrëngimeve në lidhje me kriteret e marrjes së shtetësisë. Janë planifikuar edhe aktivitete tjera. Një përqendrim tjetër do të jetë luftimi i diskriminimit përkitazi me sigurimin e automjeteve. Mirëpo, për të nisur një padi shoqërore nevojiten rreth 40000 – 50000 nënshkrime. Edhe për këtë çështje FIMM do të kërkon aleat e bashkëpunim.

## U (ri)zgjedh kryesia e re

Në pjesën e shqyrtimit të statuteve u refuzua kërkesa e kryesisë për zvo-gëlimin e anëtarëve të kryesisë. Edhe më tej numri maksimal i anëtarëve të kryesisë së FIMM do të jetë 30 veta. Ky numër i madh i anëtarëve

të kryesisë është i nevojshëm për të mundësuar përfaqësimin adekuat të shumëllojshmërisë të organizatave të migrantëve në FIMM, ishte e mendimit shumica e pjesëmarrësve. Në vijim u zhvilluan zgjedhjet e kryesisë së re, ku u zgjodhën apo u rizgjodhën përsëri 23 anëtarë të kryesisë.

Nënkryetarja e tërhequr Fiammetta Jahreis dhe Magueye Thiam u përshëndetën me flenderime për angazhimin e tyre. Në përfundim u zgjodhën Guglielmo Bozzolini dhe Mamadou Doip si dy nënkryetarët e rinj, të cilët do të jenë krah mbështetës për presidenten e vjetër dhe të re të FIMM, Emine Sariaslan.

Në fund të manifestimit delegatët e mbetur vendosën anëtarësimin në Shoqatën për një Zvicër të hapur dhe solidarë.

Shoqatat e migrantëve mund të anëtarësohen në FIMM dhe të marrin pjesë në aktivitete.

➤ Emine Sariaslan

**Kontakt:**  
emine.sariaslan@gmx.ch  
T 079 704 73 67

## Intervistë



# Sinjal i gabuar

**Partitë e djathta, para së gjithash Partia Popullore e Zvicrës (SVP) ka kohë që kërkojnë, që të shkurtohet ndihma sociale. Sulmi i bërë ndihmës sociale ka funksionuar: Në fund të muajit maj Konferenca e drejtorëve social të Kantoneve, e cila përcakton lartësinë e ndihmës sociale, ka paralajmëruar shtrëngime. Mundësitë sanksionuese do të thellohen dhe do të reduktohen mjetet për nevojat elementare të të rinjve të rritur.**

Gazeta sindikaliste Work në numrin e saj të muajit maj ka biseduar me hulumtuesin e varfërisë Carlo Knöpfer mbi shtrëngimet e pritshme. Në vijim do të japim një version të shkurtër të bisedës me te.

**Work: Carlo Knöpfer, kantone të veçanta vejnë në pikëpyetje udhëzimet e Konferencës Zvicëranë për ndihmë sociale (shkurtesa në gjermanisht: Skos). Çka është duke ndodhur?**

Modeli i deritashëm i suksesshëm i Zvicrës iu është nënshtruar presionit. Përbëhej nga tregu i punës i lakueshëm me pak mbrojtje të largimit nga puna dhe me një masë të lartë të sigurisë sociale. Fleksibiliteti i tregut të punës është duke u rritur edhe më tej, mirëpo në të njëjtën kohë ka përpjekje që të ulët mbrojtja sociale. Kjo do të ketë pasojë.

## Çfarë pasojash?

Në zhvillimin e hovshëm ekonomik kishte një lloj ashensori social përpjetë. Për të gjithë kishte përparime të caktuara. Tani më kjo nuk është më kështu. Shtresa e mesme ka drojë nga rënia sociale. Vetëm të pasurit dhe super të pasurit edhe më tej gjenden në ashensorin që shkon përpjetë, bile dhe me një lift të shpejtë.

## Shpenzimet sociale janë rritur me të vërtetë...

Kjo qëndron tek shifrat absolute, mirëpo jo në krahasim e zhvillimin ekonomik. Shpenzimet sociale që nga mesi i viteve të 1990-ta nuk janë rritur më shpejtë se sa ekonomia. Përkundër bindjes dominuese vendore, asgjë nuk do të na ikë nga dora. Nuk qëndron assesasi se ekonomia është duke u ngarkuar tej mase nga shpenzimet sociale.

## Përse vjen kërkesa për shkurtrim të shumës së ndihmës sociale bash tani?

Deri më tani nuk kemi pasur asfare shkurtimeve në sigurinë sociale. Kjo edhe përkundër asaj që SVP-ja e ka shpallur si synim në flamujt e saj. Ajo nuk ia ka rritur të reduktoj përfitimet. Teza ime është, se kjo Parti pikërisht për këtë ka ndryshuar strategjinë e saj. Ajo skandalizon rastet e veçanta nëpër komuna, dhe mediat janë duke i zmadhuar këto. Mendja më shkon në rastin e Hagenbuch-ut të Curyhut. Aty kryetari i komunës që është nga SVP-ja pretendon se duhet rritur tatimin për ndihmat sociale të një familje eritriane. Pastaj mediat përhapën këtë histori. Përmes të pavërtetave të këtitilla diskreditohet i tërë sistemi social.

## Kjo tingëllon paksa si teori e konspiracionit ...

Është fakt: Shikuar nga këndi profesional nuk ka argumente për shkurtime. Të gjitha studimet hulumtuese tregojnë se përqaqjet e Skos-it më parë janë të ulëta se sa të larta. Nëse duam që kontributet e sigurimeve shoqërore ti vendosim ashtu që ti përgjigjen nivelit të të ardhurave të 10% të popullsisë më të varfër, atëherë do të duhej rritur kontributet për 100 franga. Sot ato janë në nivelin e varfër të 7%-shit.

## Çka ndodh kur bëhen shkurtime?

Vendimtarja ndodh nëpër Kantone dhe Komuna. Këto bëjnë zbatimin e ndihmës sociale. Ekziston rreziku i një konkurrence të ndërrimit të lokaliteteve. Nëse një komunë shkurton përfitimet, atëherë komuna tjetër beson që edhe ajo duhet ta bëjë të njëjtën. Andaj tërheqë vërejtjen e shkatërrimit të digave. Pasi shkurtime në ndihmën sociale mund të shkaktojnë shkurtime në shtesën suplementare. Të djathtët do të argumentonin: Përse duhet vetëm të varfrit të shtrëngojnë rripin? Dhe sipas kësaj logjike do të kërkojnë përfundimisht edhe shkurtime të pensioneve të pleqërisë. Andaj duhet që të bëhet gjithçka është e mundur politikisht, për të penguar këtë zhvillim negativ.

➤ Ralph Hug, e përshatur, work Nr. 9, 22 maj 2015



Seminari për aktivistë sindikalist shqiptar të Zvicrës më 6 e 7 qershor

# «Debat i gjallë dhe i thellë»



Sindikalistët shqiptarë pjesëmarrës në seminarin e radhës të sindikatës Unia

**Rreth 50 sindikalistë shqiptarë në Zvicër u tubuan në një seminar në Bernë. Ata nuk dinë të flasin për gjëra të vogla. Konkluzionet e debatit do t'u paraqiten institucioneve dhe opinionit të gjerë.**

Shenjtëria e fundjavës nuk është e tillë për një grup sindikalistësh në Zvicër. Pikërisht ata që janë angazhuar më së shumti për dy ditë pushim në javë. Në fakt, për dy ditë të lira të punëtorëve nuk kanë mjaftuar shtatë ditë punë në javë. «Sindikata ofron zgjidhje, por ajo është e gatshme edhe të luftojë», është temperamentit i të gjitha sindikatave. Ato kanë edhe shumë për të bërë.

43 përfaqësues shqiptarë të seksioneve të Unias dhe personalitete të tjera të emigracionit shqiptar në Zvicër u vendosën të shtunën dhe të dielën në Hotel Bern të kryeqytetit zviceran si në një konferencë ndërkombëtare. Me tema dhe orar të caktuar fikse. Diskutime në plenum, diskutime në grupe pune, ligjëratë – ishte agjenda e seminarit të sindikalistëve.

## Kontrata Kolektive – çfarë është kjo?

Kontrata Kolektive është një marrëveshje për të drejtat e punëtorëve, të cilën sindikata e ka negociuar me punëdhënësit dhe e kujdestaron me kujdes zbatimin e saj nga ndërmarrjet. Pa të nuk do të kishte rrogë minimale në ndërtimtarë. Ndërsa punëdhënësit nuk janë të gatshëm për ruajtjen e kondicioneve të deritanishme, sindikata kërkon më shumë të drejtat për punëtorët. Sindikata kërkon respektimin e kualifikimeve të emigrantëve në branshën e ndërtimtarisë përmes njohjes së diplomave të huaja. Ajo ku sindikata nuk bën asnjë kompromis është kufiri i moshës së pensionit prej 60 vjeç në ndërtimtarë, çka është arritur me shumë përpjekje në vitin 2002

Kontrata Kolektive është një marrëveshje për të drejtat e punëtorëve, të cilën sindikata e ka negociuar me punëdhënësit dhe e kujdestaron me kujdes zbatimin e saj nga ndërmarrjet. Pa të nuk do të kishte rrogë minimale në ndërtimtarë. Ndërsa punëdhënësit nuk janë të gatshëm për ruajtjen e kondicioneve të deritanishme, sindikata kërkon më shumë të drejtat për punëtorët. Sindikata kërkon respektimin e kualifikimeve të emigrantëve në branshën e ndërtimtarisë përmes njohjes së diplomave të huaja. Ajo ku sindikata nuk bën asnjë kompromis është kufiri i moshës së pensionit prej 60 vjeç në ndërtimtarë, çka është arritur me shumë përpjekje në vitin 2002

përmes programit «Far», i cili ndryshe njihet si pensionimi fleksibël. «Kontrata kornizë Kombëtare është një garanci për punëtorët në sektorin e ndërtimit», siguron Gashi. Ai thërrret për një pjesëmarrje masovike në demonstratën e ndërtimtarëve me 27 qershor në Cyrih.

## Përse kosovarët nuk i marrin pensionet e Zvicrës?

Sindikata në angazhimin e saj për mirëqenie të përgjithshme dhe paqe sociale është e mallkuar të konfrontohet me kundërshtarë të fortë. Njëherë ishin koncernet, tani janë shtetet. Dhe këtu tonin e jep Osman Osmani, sekretari ncional për migracion.

«Ka pesë vite që Zvicra ka anuluar në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen e trashëguar për Sigurimet Shoqërore midis saj dhe Kosovës», konstaton me keqardhje Osmani. Ky vendim i ka rënë komunitetit kosovar si një damlla. Me këtë shtetasit e Kosovës, të cilët dalin në pension të moshës, apo të invaliditetit nuk i marrin kontributet e tyre të derdhura në sistemin e sigurimeve shoqërore në Zvicër nëse e lëshojnë atë. Troç: «Ata kosovarë që kthehen në vendlindje kur mbërrijnë moshën e pensionit nuk marrin pension!»

Sipas tij, për deregjenë ku janë katan-disur pensionistët kosovarë të Zvicrës «nuk janë fajtorë vetëm autoritetet zvicerane, ende më të thirrur ta rregullojnë këtë çështje janë institucionet e Kosovës». Ndërkaq Zvicra, sipas Osmanit nuk ka treguar vullnetin më të mirë për ta kaluar këtë ngërç. Sapo autoritet kosovare i kuptojnë detyrat tyre, pala zvicerane ua pret këmbët me një listë të zgjeruar të kushteve. Kulminacioni është ndoshta fakti që serbët vazhdojnë t'i marrin jo vetëm pensionet e tyre të pleqërisë, invaliditetit dhe trashëgimtarëve në vendlindje sipas marrëveshjes së trashëguar, por edhe shtesat familjare dhe

të fëmijëve deri sa të ratifikohet marrëveshja e re, e cila është negociuar nga dhjetori i 2010-ës. «Zvicra zyrtare edhe përkundër njohjes së Kosovës vazhdon të marrë në konsideratë pretendimet serbe karshi Kosovës si pjesë gjoja integrale e saj», shton Osmani. Njëherë për njëherë ai i inkurajon të rinjtë shqiptarë për pjesëmarrje në jetën politike dhe shoqërore të Zvicrës.

## Kontributi i madh me përfaqësim zero

Seminari i ofroi një platformë për t'u prezantuar nënkryetarit të SP-së në St. Gallen, Arbër Bullakaj. Ai paraqet një shembull të mirë edhe për faktin se kalkulohet si kandidat me shanse reale për në Parlamentin Federal. Jo vetëm për nder të nikoqirit, Bullakaj mirënjohu kontributin e sindikatave dhe të partisë së vet për shanset që u ka hapur njerëzve si ai, që vijnë nga shtresa jo të privilegjuara të shoqërisë. Kauza e Bullakajt është avancimi i statusit të tyre. Lajmi i tij i keq: «Përfaqësimi i shqiptarëve në Zvicër është zero!»

Çfarë do të ishin gratë pa sindikatat? Liri Lushi, e cila është mësuar t'i referohen si aktorja që luan Shotë Galicën, lëshon kushtrimin: «Ata që kanë barrën kryesore dhe mundësinë për një edukim të mirëfilltë të fëmijëve janë prindërit!». Punëtorja socio-kulturore me këtë referon thelbin e diskutimeve të grupit të punës së grave për rolin e tyre në edukimin e fëmijëve.

Fundja, sindikatat janë një instancë e cila i adreson të gjitha problemet e shtruar në seminar. Dhe përfaqësimi i shqiptarëve në sindikata është një formë e participimit publik, si të tjerat. Hilmi Gashi, si një sindikalist i regjitur, prezanton statusin e shqiptarëve në Unia. Gjendja, sipas tij, paraqitet e zymtë. Ai ia vjedh spektaklin ish-aktore me improvizimin e forcës së një rrjeti duke «i lidhur» pjesëmarrësit në seminar me njëri-tjetrin përmes fijeve të një lëmsi. Mesazhi i tij: «Nëse dëshirojmë të jemi faktor duhet më shumë angazhim dhe solidaritet. Edhe atë jo vetëm në shërbim të interesave partikulare, por edhe atyre të përgjithshme, sepse benifitet vlejnjë edhe për secilin».

Për Osman Osmanin, puna përbën pjesën më të rëndësishme të kohës së njeriut, prandaj edhe angazhimi rreth saj është plotësisht i ligjësuar. Ai, si edhe Hilmi Gashi, është i kënaqur nga vajtja e seminarit. Osmani është i befasuar këndshëm nga disiplina dhe përpikëria e pjesëmarrësve në seminar. Sidomos nga pjesëmarrja e të rinjve dhe grave, të cilat përbënin rreth një të tretën e panelit. «Debatit ka qenë i gjallë dhe i thellë», e konfirmon Osmani – Gashin. Ai ndërkohë do të nxjerrë një dokument të shkruar dhe në formë të një rezolute, konkluzionet e seminarit do t'i paraqiten organizatës dhe opinionit.

© Kujtim SHABANI, dialogplus.ch



Aktivizohet edhe rinia jonë



Drejtusi sindikalist duke referuar



Rrjetëzimi ndihmon faktorizimin shqiptar në sindikat dhe shoqëri



## Punë temporale në vend të punësimit të rregullt: Më mirë i papunë?

**Në verë përfundoj aftësimin tim profesional (zanatin) si kuzhinier. Deri më tani mjerisht nuk kam gjetur vend pune. Tani së fundi shefja ime më ka ofruar mundësin që si punëtor temporal të qëndroj deri në fund të tetorit në ndërmarrje ku kam kryer pjesën praktike të punës. Në të vërtetë unë nuk kam dëshirë të punojë edhe më tej në të njëjtin restorant, dhe jam duke menduar se në vend të kësaj të lajmërohem si i papunë. A është kjo e mundshme?**

Po si, e mundshme është, mirëpo ne ju këshillojmë të hiqni dorë nga kjo. Nëse lajmëroheni si i papunë, edhe në rast se keni mundësi për një punë të arsyeshme, kjo pastaj vlen si «papunësi e vetshkaktuar». Konsekuencat janë: Arka e sigurimit të papunësisë ua imponon të ashtuquajturat «ditë të humbura»: Kjo d.m.th. se ju në 3 muajt e parë të papunësisë suaj nuk merrni fare kompensim, megjithatë ju duhet të kryeni të gjitha obligimet tjera karshi Entit Regjional për ndërmjetësim pune dhe karshi Arkës së sigurimit të papunësisë, si fjala bie terminët këshilluese, ose shkrimi i aplikacioneve. E njëjta ndodh edhe nëse ju thjesht prishni marrëveshjen mbi marrëdhënien e punës, par se të gjeni një vend të ri pune. Është edhe një arsye tjetër pse ju duhet të pranoni ofertën e shefes suaj: Nëse keni punuar 3 muaj me pagë të një kuzhinieri të kualifikuar dhe më pas faktikisht ju duhet të lajmëroheni si i papunë, atëherë do të merrni m kompensim shumë më të lartë nga Arka e sigurimit të papunësisë se sa menjëherë pas mësimit të zanatit. Kompensimi do të përlogaritë duke marrë parasysh pagat e 6 muajve të fundit.

Timur Öztürk, work, 4.6.2015

## Sigurimi i pensionit të invaliditetit (IV/AI): A duhet ta lajmëroj rritjen e pensionit?

**Pasi gjendja ime shëndetësore është përkeqësuar, pensioni im i invaliditetit duhet të ri sqarohet, dhe unë do të marrë një pension më të lartë retroaktiv. Krahas kësaj unë marr edhe shtesën suplementare. Kolegja ime më ka thënë se unë duhet ta lajmëroj rritjen e pensionit në Entin kantonal për shtesë suplementare, d.m.th. Entit që paguan shtesën suplementare. A është e vërtetë kjo?**

Po, gjithsesi dhe gjithmonë. Të gjitha ndryshimet e rëndësishme tek të ardhurat apo pasuria duhet t'i lajmëroni menjëherë tel Enti përgjegjës për shtesat suplementare. Derisa tani merrni një pension më të lartë atëherë kanë ndryshuar edhe bazat e përlogaritjes për shtesën suplementare. Ju posedoni tani më shumë para se sa është marr me mend fillimisht. Enti për shtesat suplementare guxon të korrigjoj vendimin e mëhershëm dhe për pjesën tjetër të vitit kalendarik të përshtatë atë. Me këtë rast është me rëndësi: Nëse më vonë dal në shesh apo sqarohet se dikush përmes së drejtës për shtesë suplementare ka pasur pasuri më shumë se sa ka qenë e njohur gjatë përlogaritjes apo është deklaruar, ky person duhet shumë të tepër të marr ta kthej.

Philip Thomas, work, 7.5.2015

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, D. Filipovic, E. Sariastan, M. Martín, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck NZZ Print, Zürcherstrasse 39, 8952 Schlieren | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch